



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre në detyrë
Ministria e Drejtësisë

Z. Arben Vitia, ministër në detyrë
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Z. Ismail Dibrani, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 6 gusht 2025

Hyrje

Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm: MKP), më 10 prill 2025 vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM), për t'u informuar për gjendjen e përgjithshme në këtë qendër. Ndërsa më 22 maj 2025 i dërgoi e-mail zyrtar drejtorit të QPM-së për informata shtesë dhe më 23 maj 2025 kemi marrë e-mail nga drejtori i QPM-së me informatat që kemi kërkuar.

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria; vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dërguara përmes raportit me rekomandime, të datës 18.10.2021; hapja e kutive të ankesave; intervistimi i të paraburgosurve/burgosurve, të cilët kanë telefonuar në LAP; si dhe intervistimi i rasteve me lëndime trupore, të cilat janë përcjellë nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB).

Përbërja e grupit monitorues

1. Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- drejtoresha e MKP-së;
- këshilltari juridik për parandalim të torturës;
- këshilltarja-psikologe;
- këshilltarja-punëtore sociale;
- këshilltarja juridike nga zyra rajonale në Mitrovicë.

Bashkëpunimi i autoriteteve me MKP-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës, bashkëpunimi i zyrtarëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës (më tej: ShKK) me zyrtarët e Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më tej: DShB) ishte i nivelit korrekt. Ekipi pati qasje në të gjitha vendet që i vizitoi, i janë siguruar të gjitha informacionet e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe me të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues.

Keqtrajtimi fizik

3. Gjatë vizitës në QPM, MKP-ja ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të të dënuarve dhe nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues. Në përgjithësi, komunikimi ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve ishte i nivelit të kënaqshëm.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

4. Bazuar në nenin 31 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me rastin e pranimit në institucionin korrektues, personi i dënuar njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar, i cili nuk di shkrim dhe

lexim, njoftohet gojarisht.¹ MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se të pranuarit në QPM njoftohen për të drejtat e tyre.

5. Në nenin 23, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese potencohet se, sipas kërkesës së personit të dënuar ose të paraburgosur, mund t'i mundësohet që të njihet edhe me Kodin përkatës Penal të Republikës së Kosovës, me Kodin përkatës të Drejtësisë për të Mitur dhe me Kodin përkatës të Procedurës Penale.²

Kushtet e akomodimit

6. Në QPM kapaciteti zyrtar është për 68 persona. Në ditën e vizitës ishin të akomoduar 42 të burgosur, nga ta 13 të paraburgosur dhe 29 të dënuar. Kurse, sipas informatave që pranuan nga drejtori i QPM-së, më 23 maj 2025 ishin të akomoduar 45 të burgosur, prej tyre 11 të paraburgosur dhe 34 të dënuar, të nacionaliteteve të ndryshme, nga ta 20 shqiptarë, 11 serbë, 5 boshnjakë, 5 romë dhe 4 turq.
7. Gjatë monitorimit në QPM, MKP-ja mori disa ankesa nga të burgosurit lidhur me kushtet e akomodimit. Lidhur me këto pohime, ekipi monitorues vizitoi dhomat në katin e dytë ku qëndrojnë të burgosurit dhe u vërejt edhe nga ekipi monitorues se në kuptim të hapësirës disa qeli nuk janë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) dhe as me standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT). Po ashtu u vërejt se të burgosurve u mungojnë dollapët adekuatë për vendosjen e gjësendeve të tyre.
8. Neni 35 i LESP-së përcakton: *"Hapësira në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje."*³
9. Kurse në nenin 19 të Udhëzimit Administrativ MD – nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese potencohet: *"Të dënuarit i sigurohet dollap i vogël, respektivisht ndarje e posaçme në dollap ose pjesë e posaçme e orendisë për mbajtjen e sendeve të cilat mund t'i ketë me vete."*⁴
10. Gjatë vizitës në QPM u vizituan edhe dhomat të cilat janë mbyllur me rekomandim të CPT-së, për shkak se nuk i plotësojnë kriteret.
11. Neni 36, paragrafi 1, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁵ shprehimisht përcakton: *"Personi i dënuar ka të drejtë në strehim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike."*
12. MKP-ja u njoftua se në QPM janë gëlqerosur të gjitha dhomat dhe është bërë rinovimi i sistemit të furnizimit me ujë, kurse në plan është rregullimi i kanalizimit.

¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31, paragrafi 2.

² Udhëzim Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 23, paragrafi 3.

³ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 35, paragrafi 2.

⁴ Udhëzim Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 23, paragrafi 19.

⁵ Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

13. Gjatë vizitës u vërejt se edhe hapësirat e zyrtarëve korrektues nëpër pavijone janë të vogla, nuk kanë ventilim e as dritë natyrale, gjë që nuk i plotësojnë kushtet për të qëndruar me orar të gjatë. Kulla vrojtuese që i mbikëqyr shëtitoret nuk ka kushte adekuate për personelin që qëndron aty. Gjatë verës bëhet tepër nxehtë, kurse gjatë dimrit tepër ftohtë.

Kuzhina e QKD-së

14. Në kuzhinën e QKD-së, higjiena ishte në nivelin e duhur. Kuzhina ishte e pajisur me të gjitha elementet të cilat ishin funksionale për përgatitjen e ushqimit. U vërejt se në punë ishin të angazhuar kryekuzhinieri, 2 kuzhinierë dhe si dhe 3 të burgosur të angazhuar në punë të ndryshme në kuzhinë.
15. Të gjithë të angazhuarit në kuzhinë, përfshirë këtu edhe të burgosurit, posedonin librezë sanitare e që ishin në përfundim të afatit, mirëpo kishin bërë kërkesë që t'u vazhdohet afati i librezave sanitare. Personeli i kuzhinës ishte i pajisur me uniforma adekuate dhe dorëza. Ushqimi ishte me afat dhe i ruajtur mirë.

Ushqimi

16. MKP-ja gjatë vizitës në QPM ka pranuar disa shqetësime nga disa të burgosur, lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimi që u servohet. Të burgosurit pohuan se edhe përkundër asaj që e kanë rekomandimin nga mjeku për ushqim dietal, nuk u shërbehet rregullisht.
17. Rregullat e Mandelës – Rregullat Standarde të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve⁶ theksojnë: *“Çdo i burgosur duhet të ketë ushqim të mjaftueshëm dhe me vlera ushqyese për ruajtjen e shëndetit dhe forcës, që të jetë i përgatitur në mënyrë të pastër dhe të shëndetshme. Uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion për çdo të burgosur.”*
18. Neni 38 i LESP-së⁷ përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë në ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe fuqisë së tij në tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Personi i dënuar i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë në ushqim të caktuar nga mjeku.”*

Kujdesi shëndetësor

19. Në nenin 42 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale theksohet: *“Përkujdesja shëndetësore në institucion korrektues bëhet në pajtim me rregullat e përgjithshme për përkujdesje shëndetësore, për sigurim shëndetësor dhe për shërbime mjekësore dhe farmaceutike, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe.”*⁸
20. Në QPM shërbimet mjekësore ofrohen nga një mjek, i cili është pensionuar, mirëpo Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB) ia ka vazhduar kontratën për tri vjet dhe ofron shërbime çdo ditë nga dy orë dhe është në thirrje 24 orë. Përveç mjekut, shërbime mjekësore ofrojnë edhe 6 infermierë me orar të rregullt, ku 5 prej tyre punojnë me ndërrime, ndërsa kryeinfermierja nga ora 08:00 deri në 16:00, një psikolog me kontratë të

⁶ Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

⁷ Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 38, paragrafët 1 dhe 2.

⁸ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 42, paragrafi 3.

rregullt dhe me orar të plotë, një stomatolog dhe një psikiatër të kontraktuar, të cilët punojnë në ditë të caktuara dhe sipas nevojës.

21. Për sa i përket infrastrukturës, Njësia Shëndetësore posedon një dhomë ku kryhen vizitat mjekësore, intervenimet, trajtimet psikologjike, psikiatrike dhe kjo po paraqet shpeshherë vështirësi për stafin mjekësor. Psikologu nuk posedon dhomë të veten dhe i shfrytëzon hapësirat e lira si p.sh. sallën e trajnimeve apo ndonjë hapësirë tjetër. Psikologu mban seanca individuale, ndërsa seancat grupore nuk i realizon për shkak të mungesës së hapësirave. Hapësirat e Njesisë Shëndetësore nuk janë adekuate për ofrim të shërbimeve mjekësore dhe psikologjike dhe rrezikojnë konfidencialitetin.

Shërbimet e tjera mjekësore ofrohen nga qendra më e afërt e mjekësisë familjare dhe nga Spitali Rajonal i Mitrovicës. Përveç kësaj, Njësia Shëndetësore i posedon të gjitha protokollet relevante mjekësore. Nga dokumentacioni i analizuar, MKP-ja ka vërejtur se në vitin 2025 janë evidentuar 2 vetëlëndime, 2 lëndime trupore, asnjë rast tentim-vetëvrasjeje, asnjë rast i vdekjes, 2 raste me grevë urie, 1 rast me masën e vetmisë, si dhe asnjë lajmërim për abuzime seksuale.

Bazuar në statistika, 13 raste janë dërguar për shërbime mjekësore jashtë burgut, kryesisht raste me probleme kardiovaskulare, kurse 15 raste përdorin terapi psikiatrike dhe janë raste të menaxhueshme.

Për sa i përket furnizimit me barna, nuk kemi marrë ankesa nga të burgosurit për mungesë të barnave, furnizimi me barna ishte i mjaftueshëm.

MKP-ja gjatë vizitës ka pranuar shumë ankesa nga të burgosurit e nacionalitetit shqiptar se komunikimi me stafin mjekësor është shumë i vështirë, për shkak se nuk e flasin gjuhën shqipe. Kërkesa e të burgosurve shqiptarë (të cilët janë mbi 25-26) është që të angazhohen mjekë dhe infermierë shqiptarë, në mënyrë që komunikimi të jetë më i lehtë.

Regjimi

22. Të burgosurit në QPM mund të dalin në shëtitje – ajrosje dy herë në ditë, në kohëzgjatje prej 1 ore. Në kuadër të QPM-së funksionojnë pesë punëtori: metalpunues, zdrukthëtari, rrobaqepësi, kuzhinieri dhe furrë buke, ku janë të angazhuar 5 të burgosur, kurse të angazhuar në punë në pastrim, kuzhinë etj. janë 19 të burgosur. Të burgosurit mund ta shfrytëzojnë edhe bibliotekën dhe shëtitoren ku janë instaluar pajisjet e ushtrimeve.
23. Gjatë vizitës në QPM, ekipi i MKP-së ka pranuar ankesa të shumta nga të burgosurit, për faktin se shëtitoret janë shumë të vogla, gjatë ditës nuk e realizojnë asnjë aktivitet dhe shumicën e kohës e kalojnë mbyllur në qeli dhe atë me çelës.
24. Sipas informatave nga drejtori i QPM-së, në dispozicion të të burgosurve janë edhe trajnimet dhe programet, si: menaxhimi i zemërimit, biseda për ndryshim, trajnimi për kuzhinier, zdrukthëtari, saldator dhe në fund pajisen me certifikata të rregullta. Aktivitetet që realizojnë të burgosurit janë: palestër, futboll, basketboll, volejboll dhe shah.
25. Lidhur me regjimin e varfër në QPM, edhe në të kaluarën MKP-ja e Avokatit të Popullit ka shprehur shqetësim dhe ka rekomanduar që të bëhen përpjekje për të rritur angazhimin

e të burgosurve në punë dhe në aktivitete të ndryshme, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.⁹

Kontakti me botën e jashtme

26. Në dispozicion të të dënuarve dhe të të paraburgosurve në QPM janë vizitat familjare, telefonatat, si dhe vikendet për të dënuarit të cilët i plotësojnë kriteret.
27. Neni 61 i LESP-së¹⁰ përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë në pranimin e vizitave së paku një herë në muaj në kohëzgjatje prej së paku një (1) orë nga bashkëshorti/ja, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi, prindi adoptues dhe të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.”*
28. Personat e dënuar gëzojnë të drejtën edhe për telefonata. Lidhur me të drejtën telefonike, neni 59 i LESP-së¹¹ përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike dhe të komunikoj në forma të tjera të komunikimit elektronik.”*
29. Lidhur me të drejtën për telefonata, janë pranuar ankesa nga të burgosurit e nacionalitetit shqiptar se telefonatat nuk u lejohen më shumë se 10 minuta.
30. Personi i paraburgosur dhe ai i dënuar mund të kontaktojë me avokatin e tij pa kufizim dhe pa mbikëqyrjen e përmbajtjes së korrespondencës. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen edhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKP) i Avokatit të Popullit përmes telefonit apo përmes kutive të vendosura nëpër pavijone.
31. Neni 40 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese¹² përcakton: *“Korrespondenca e të burgosurit me Avokatin e Popullit të Kosovës është e privilegjuar që do të thotë se nuk duhet të kontrollohet në asnjë mënyrë.”*
32. Më tej ky udhëzues përcakton se Avokati i Popullit ka të drejtë korrespondence me të paraburgosurin ose me të dënuarin, në çdo kohë dhe pa paralajmërim.
33. Sipas informatave që kemi pranuar përmes e-mailit nga drejtori i QPM-së, shtetasit e huaj që janë të akomoduar në QPM e kanë shfrytëzuar aplikacionin SKYPE, kurse nga data 11 maj 2025, aplikacioni SKYPE nuk është funksional.

Procedurat e ankesave

34. Personi i dënuar njoftohet për të drejtat dhe detyrimet e të burgosurve si dhe me procedurat e paraqitjes së ankesave dhe kërkesave. Personat e vendosur në burgje dhe në qendra të paraburgimit duhet të kenë mundësi të parashtrojnë ankesë në këto qendra dhe qasja tek autoriteti i duhur duhet t'u mundësohet në mënyrë konfidenciale.
35. Neni 90 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë të parashtrojë ankim te drejtori i institucionit korrektues lidhur me shkeljen e të*

⁹ Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, publikuar me 18.10.2021. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/10/18/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-mitrovice/>

¹⁰ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 61, paragrafi 1.

¹¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 59, paragrafi 1.

¹² Udhëzim Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, Neni 40, paragrafi 1.

*drejtave të tij ose me parregullsitë e tjera që i janë bërë atij në institucionin korrektues.*¹³

36. Në dispozicion të të burgosurve në QPM janë të vendosura kutitë e ankesave nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, nga DShB-ja dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesave.

Konstatimet e MKP-së së Avokatit të Popullit

37. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP) i Avokatit të Popullit, bazuar në gjetjet nga vizita, konstaton se qelitë në këtë qendër, në aspektin e hapësirës, nuk përputhen me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) dhe as me standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës. Gjithashtu të burgosurve nëpër qeli u mungojnë dollapët për ruajtjen e gjësendeve personale.
38. Hapësirat e zyrtarëve korrektues nëpër pavijone janë shumë të vogla, nuk kanë ventilim e as ndriçim natyral. Po ashtu, zyrtarët në Kullën Vrojtuese që i mbikëqyrin shëtitoret nuk kanë kushte adekuate, për shkak se gjatë verës është shumë nxehtë, kurse gjatë dimrit shumë ftohtë.
39. Të burgosurve nuk u ofrohet ushqimi dietal sipas rekomandimit të mjeku, po ashtu sasia dhe cilësia nuk janë të mjaftueshme.
40. Hapësira për ofrimin e shërbimeve mjekësore nuk është e përshtatshme pasi që në të njëjtën hapësirë ofron shërbime stomatologu, mjeku, psikiatri dhe ndonjëherë edhe psikologu.
41. Mungesa e hapësirës së veçantë për ofrimin e shërbimeve mjekësore rrezikon ruajtjen e konfidencialitetit.
42. Mungesa e një zyrtari për përkthim në gjuhën shqipe paraqet vështirësi për stafin mjekësor dhe për të burgosurit shqiptarë. Kjo vërehet sidomos gjatë realizimit të vizitës mjekësore, ku përkthimi zakonisht sigurohet nga vet zyrtarët e stafit korrektues gjë që nuk siguron konfidencialitet.
43. Të burgosurve nuk u ofrohen shumë aktivitete dhe shumicën e kohës e kalojnë mbyllur në dhoma, dhe atë me çelës.
44. Të burgosurve të nacionalitetit shqiptar nuk u mundësohen telefonatat më shumë se 10 minuta.
45. Të burgosurit, shtetas të huaj, nuk mund ta shfrytëzojnë aplikacionin SKYPE, për shkak se nuk është funksional.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i

¹³ Neni 90, paragrafi 5, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- T'i përmirësojë kushtet e jetesës për të burgosurit e akomoduar në këtë qendër, në kuptim të hapësirës dhe të kushteve të akomodimit (sigurimi i dollapëve), në pajtim me LESP-në dhe me standardet e KPT-së.
- Të krijohen kushte pune adekuate për personelin korrektues në QPM.
- Të burgosurve t'u sigurohet ushqim cilësor dhe i mjaftueshëm, si dhe ushqim dietal sipas rekomandimit të mjekut.
- Të krijohen hapësira të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve mjekësore nga psikiatri, stomatologu dhe psikologu, pasi të njëjtën hapësirë e shfrytëzojnë të gjithë.
- Të shtohen më shumë aktivitete jashtë qelisë për rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve, në pajtim me LESP-në dhe me Kodin e Procedurës Penale, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.
- Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që kohëzgjatja e telefonatave të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Të bëhen përpjekje në mënyrë që të funksionalizohet SKYPE, për t'ua mundësuar shtetasve të huaj që janë në vuajtje të dënimit komunikimin me familjet e tyre, kur nuk kanë mundësi për telefonatë apo për vizitë.

Ministrisë së Shëndetësisë

- Të burgosurve shqiptarë në QPM t'u ofrohen shërbimet mjekësore dhe psikologjike në gjuhën të cilën ata e kuptojnë.
- Të sigurohet ruajtja e konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore për të burgosurit e akomoduar në këtë qendër, duke garantuar që shërbimet e ofruara nga mjeku, psikologu dhe stomatologu të kryhen në hapësira të veçanta dhe pa praninë e zyrtarëve korrektues.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit